



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E SHTIMES
MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Procesverbal nga takimi publik me qytetarë për Projektin e KEDS-së (shtrirja e rrjetit nëntokësorë të kabllave) e mbajtur më 5 maj 2025, në ora 14:00, në Sallën e Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryetari i Komunës së Shtimes, Qemajl Aliu, drejtorë komunalë, zyrtarë komunal, përfaqësues nga KEDS, përfaqësues nga operatori ekonomik, përfaqësues nga operatorë të ndryshme dhe qytetarë.

Qemajl Aliu: Ju falënderoj të gjithëve që i jeni përgjigjur ftesës për të qenë këtu sot. Përveç Kryesuesit, Shefit të Kabinetit dhe Drejtorëve, sot janë të pranishëm edhe përfaqësuesit e KEDS-it, të cilët do të prezantojnë një projekt për investim, i cili do të diskutohet sot. Siç jeni të informuar, bëhet fjalë për një investim të planifikuar nga KEDS-i për këtë vit, një projekt që e kam kërkuar si Kryetar i Komunës që nga dita e parë, së bashku me stafin tim.

Së fundmi kemi zhvilluar një takim një javë më parë me Drejtorin e KEDS-it, z. Turan i cili është Drejtori i kompanisë, dhe ai, së bashku me bashkëpunëtorët dhe inxhinierët e tij, na ka propozuar dhe prezantuar një projekt investimi në qendrën e Shtimes.

Siç dihet, shtyllat elektrike në qytet, përveç se janë të ngarkuara me kabllot elektrike, mbajnë edhe kabllot e kompanive të internetit dhe postës. Duke pasur parasysh këtë situatë, që nga ardhja në detyrë kemi dërguar disa shkresa jo vetëm një, por pesë apo gjashtë shkresa të cilat përfaqësuesi i KEDS-it mund t'i konfirmojë. Megjithatë, KEDS-i deri më tani nuk ka pasur mundësi të ndajë një shumë financiare për këtë investim. Bëhet fjalë për një fond prej rreth gjysmë milioni euro, të cilin KEDS-i, vetëm këtë pranverë ka arritur ta alokojë për investimin në qendrën e qytetit të Shtimes.

Në veçanti ky investim do të zbatohet në segmentin që përfshin rrugën Tahir Sinani, nga shkolla fillore Emin Duraku deri te Enver Gashi, si dhe sheshin Ahmet Shtimja deri te rruga 14 Dhjetori. Në këtë zonë, të gjitha shtyllat elektrike ekzistuese do të eliminohen dhe infrastruktura do të vendoset nën tokë, duke bërë që hapësira publike të mos ketë më shtylla dhe kablllo që jo vetëm prishin pamjen estetike, por pengojnë edhe lëvizjen e këmbësorëve dhe automjeteve.

Si Kryetar i Komunës, duke e ditur që implementimi i këtij projekti sjell edhe sfida të veta, është e nevojshme të ndërhyhet për hapjen e një kanali, i cili do të shtrihet nga rruga Emin Duraku deri te Trekëndëshi, pastaj deri te ura pranë Xhamisë dhe nga cepi i parkingut në rrugën 14 Dhjetori deri te Unaza e Re.

Realizimi i këtij projekti kërkon kohën e tij dhe, natyrisht, do të ketë pengesa, sidomos për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe funksionimin e bizneseve në këtë zonë. Megjithatë, duhet të kuptojmë që çdo investim i tillë sjell një periudhë kalimtare me vështirësi, por rezultati përfundimtar është i mirëseardhur. Siç ndodh edhe në jetën e përditshme kur rinovojmë shtëpitë tona dhe përkohësisht prishim komoditetin, në fund investimi sjell një përmirësim domethënës.

Në komunat e tjera, investime të ngjashme janë realizuar përmes bashkëpunimit ku një pjesë financohet nga komuna dhe një pjesë nga KEDS-i. Megjithatë, në rastin tonë, Drejtori i KEDS-it, duke marrë përsipër vonesën e projektit, ka vendosur që kompania të mbulojë të gjithë koston e këtij investimi. Për të qenë transparentë me ju, qytetarët që na kanë besuar me këto detyra, kemi organizuar këtë takim për të bërë prezantimin e projektit.

Tani fjalën e ka menaxheri nga KEDS-i, i cili do të na informojë mbi fazat e zbatimit të projektit dhe afatet kohore. Pas kësaj, ne do të japim vendimin tonë nëse duhet apo nuk duhet të miratohet ky projekt.

Fatmir Jashari: Përhëndetje të gjithëve! Jam përfaqësues i kompanisë KEDS dhe do të bëj një prezantim të shkurtër mbi projektin që, siç e përmendi edhe Kryetari, ka për qëllim përmirësimin e rrjetit elektrik në qendër të Shtimes.

Ky projekt përfshin: shtrirjen e rrjetit elektrik nëntokësor nga shkolla Emin Duraku deri te Trekëndëshic rregullimin e infrastrukturës elektrike në rrugën 14 Dhjetori, ku aktualisht ekziston një pengesë në rrugë, eliminimin e tri shtyllave elektrike në shesh dhe vendosjen e rrjetit

nëntokësor, ndërtimin e kanalit kryesor në rrugën kryesore, pranë trafos së KEDS-it, plotësimin e një kanali të mëparshëm që ka mbetur i papërfunduar, vendosjen e ormanave mjedisore për furnizimin me energji të objekteve përkatëse, zëvendësimin e kabllave ajrore me kabllonëntokësore për të përmirësuar estetikën dhe kapacitetin e rrjetit.

Në hartimin e projektit kemi marrë parasysh faktorët teknikë dhe kemi paraqitur pozicionimin e kabllave kryesore që mundësojnë kyçjen deri te secili objekt. Për realizimin e projektit, përveç punimeve në trotuare, do të nevojiten edhe ndërhyrje në oborret e disa objekteve për sigurimin e furnizimit me energji elektrike. Si KEDS, bashkëpunojmë me palët e tjera për lirin e hapësirave publike dhe për vendosjen e kabllave të reja që sigurojnë furnizim më të mirë për qytetin duke pasur parasysh se hapësirat janë të kufizuara.

Ky është një prezantim i përgjithshëm i projektit. Punimet pritet të zgjasin rreth 2 – 2.5 muaj dhe do të sjellin një pamje shumë më të mirë për qytetin. Ia vlen të pritet, pasi përveç pamjes vizuale, ky investim do të përmirësojë edhe lëvizjen e qytetarëve dhe trafikun.

Nëse keni pyetje, jemi të gatshëm të përgjigjemi. Ju faleminderit!

Qemajl Aliu: Fjala ju takon juve, si përfaqësues të bizneseve dhe si familjarë. Gjithashtu janë të pranishëm edhe përfaqësuesit e operatorëve si Kujtesa dhe Telkos, pasi ky proces nuk përfshin vetëm rregullimin e rrjetit elektrik, por është një projekt i koordinuar bashkërisht edhe me ju. Si e mendoni këtë projekt? A keni ndonjë pyetje për sqarim, koment apo vlerësim?

Lulzim Mustafa: Përshëndetje! Duke qenë se punimet do të zgjasin rreth 2 muaj e gjysmë, e di që do të ketë ndërprerje të energjisë elektrike. A do të ketë ndërprerje gjatë natës? Sepse nuk mund të përdorim gjenerator për shkak të zhurmës.

Fatmir Jashari: Jo, gjatë natës nuk do të ketë ndërprerje të energjisë elektrike. Edhe gjatë ditës, ndërprerjet do të jenë minimale, por mund të ketë pengesa, veçanërisht gjatë hapjes së kanaleve.

Lulzim Mustafa: Po për ormanët, si është planifikuar?

Fatmir Jashari: Ormanët do të jenë 6 dhe 12 pjesorë, sipas nevojës së projektit.

Lulzim Mustafa: Ju faleminderit!

Fatmir Jashari: Gjithashtu, sa i përket çështjes së operatorëve, dua të theksoj që kemi paraparë gypat kryesorë për shtrirjen e kabllave të operatorëve. Këto do të vendosen nga ormani deri te secili objekt, duke lënë një gyp të lirë për çdo operator pas realizimit të projektit.

Pas përfundimit të punimeve, operatorët duhet të arrijnë një marrëveshje për financimin e një pjese të bazamentit, pasi ajo nuk është e paraparë nga KEDS-i. Megjithëse vlera nuk është shumë e madhe, është e rëndësishme që operatorët të bashkëpunojnë për ta financuar këtë pjesë dhe ta vendosin së bashku.

Xhevat Qorri: Përshëndetje i nderuar Kryetar dhe të nderuar të pranishëm! Jam përfaqësues i Telekom-it. Ne si Telekom do të jemi pranë jush dhe ju mirëpresim për bashkëpunim, pasi ky projekt është shumë i rëndësishëm. Jemi mbështetësit tuaj, por duhet të kemi parasysh që infrastruktura jonë është e ndjeshme.

Fatmir Jashari: Faleminderit! Ne do të bëjmë çmos për të mos shkaktuar dëme, sepse edhe për ne çdo dëmtim është një kosto e konsiderueshme për ta rregulluar. Ju mirëpresim për bashkëpunim!

Xhevat Qorri: Sa i përket planit që keni hartuar, kërkoj që të jeni të kujdesshëm gjatë punimeve, sidomos tek gypat.

Fatmir Jashari: E mirëpresim çdo bashkëpunim me ju! Gjithashtu, një aspekt që nuk e kam përmendur më herët është shtimi i një shtylle të re, e cila do të ndikojë në furnizimin më të qëndrueshëm të energjisë elektrike në qendër. Ky investim do të lehtësojë kyçjet e reja dhe do të sigurojë furnizim më korrekt.

Shpresim Selimi: Përshëndetje! Fillimisht kërkoj ndjesë nëse po dal pak jashtë temës, por kemi një problem serioz me cilësinë e energjisë elektrike në lagjen tonë, Lagjja e Pajtimit. Ky është një problem i njohur dhe na është premtuar prej vitesh një trafostacion, por nuk është realizuar ende. Për shkak të kësaj situatë, e kemi të pamundur të kryejmë edhe punët më elementare, pasi tensioni është shumë i ulët. KEDS-i e di për këtë çështje prej shumë vitesh, por nuk ka ndërmarrë masa. Ne si banorë të lagjes kemi vendosur të mos paguajmë faturat e energjisë derisa të rregullohet ky problem. Sidomos kur ka ngarkesa më të mëdha, si gjatë periudhës kur kthehen mërgimtarët, situata bëhet edhe më e rëndë.

Fatmir Jashari: Ne jemi ekip që merremi me planifikimin urban dhe dizajnin e projekteve të qytetit, kështu që nuk kemi informacion të detajuar për atë pjesë. Megjithatë, mund ta shqyrtojmë së bashku për të parë nëse mund të bëjmë diçka. Një kërkesë zyrtare përmes Kryetarit mund të ketë ndikim dhe të ndihmojë në adresimin e këtij problemi.

Shpresim Selimi: Përveç kësaj, ne kemi bërë edhe një peticion.

Fatmir Jashari: E kuptoj.

Qemajl Aliu: Shpresim, faleminderit! Ne kemi dëshmi të mjaftueshme, si takime me drejtorin dhe përfaqësuesit e KEDS-it jo vetëm për Lagjen e Pajtit, por edhe për Rashincën, Carralevën dhe Pjetershticën. Të gjitha këto komunikime janë të shoqëruara me emaila, kërkesa dhe peticione të qytetarëve. Strategjia e investimeve të KEDS-it ka pasur një dinamikë jo fort të kënaqshme. Ne kemi kërkuar të fokusohet fillimisht në qendër, pasi qyteti ka më shumë se 10,000 banorë dhe është më i domosdoshëm për zhvillimin urban. Nuk është qëllimi të diskriminojmë fshatrat, por të ofrojmë një zgjidhje konkrete, pasi shumica e popullsisë dhe bizneseve janë në qytet, dhe pastaj mund të shtrihemi drejt periferisë.

Pas takimit me Drejtorin e Përgjithshëm të KEDS-it, u pa qartë se bashkëpunimi me qeverisjen e kaluar ka qenë i dobët, duke shkaktuar vonesa. Ne kemi vullnetin për bashkëpunim, sidomos për Lagjen e Pajtit, e cila është një vendbanim i ri dhe po zhvillohet me ritme të shpejta. Çdo ditë popullsia po shtohet, ndërsa furnizimi me energji është gjithnjë e më i dobët.

Tema e sotme lidhet me planin e investimit, dhe duke qenë një komunë me shumë mërgimtarë, duam t'i presim me qetësi dhe kushte të mira. Kjo është arsyeja pse ky projekt është kaq i rëndësishëm për ne. Për dallim nga komunat e tjera, Drejtori i KEDS-it ka treguar zemërgjerësi, duke e financuar plotësisht këtë investim pa kërkuar kontribut financiar nga komuna. Ky është një projekt i domosdoshëm dhe i mirëseardhur, por është e rëndësishme të kemi parasysh që gjatë punimeve do të ketë zhurmë dhe vështirësi në lëvizje. Ju ftoj që kur të fillojnë punimet, të kemi mirëkuptim dhe bashkëpunim për t'i kaluar sfidat bashkërisht. Nëse e shohim të arsyeshme që të fillojmë tani, e marrim përsipër me të mirat dhe sfidat që sjell. Nëse jo, vendimi do të mbetet i hapur. Sakrificat janë të nevojshme, por përfundimi i projektit do të sjellë një lehtësim të madh për qytetin.

Gjithashtu, kemi një projekt të buxhetuar për Rrugën Tahir Sinani, nga shkolla fillore Emin Duraku deri te rruga 12 Qershori, ku do të shtohet një shtresë e dytë asfaltimi, pasi janë hapur gropa në zonë. Një shtresë e dytë do të vendoset edhe në Rrugën Adem Jashari, deri te lokali Classic, për të përmirësuar cilësinë e infrastrukturës. Kjo na mundëson që pas përfundimit të projektit elektrik, të vendosim dy shtresa të reja të asfaltit, duke rregulluar trotualet dhe urbanizimin në mënyrë cilësore. Nëse secili prej nesh sakrifikon pak, përfitojmë shumë. Megjithatë, më pas nuk dua të dëgjoj ankesa se “Kryetar, na more në qafë në kohën e mërgimtarëve”, sepse diçka duhet të sakrifikojmë si komunë dhe ju si biznese.

Ky projekt është kërkuar prej shumë vitesh, dhe nuk është gjithmonë e mundur të realizohet. Kështu që dëshiroj të dëgjoj mendimet tuaja, sepse ne e marrim përsipër jo vetëm implementimin, por edhe rikthimin në gjendjen e mëparshme brenda një periudhe rekord. Ju faleminderit!

Nazmi Ademaj (qytetar): Ju lutem, keni parasysh kohën, sepse ne e dimë që nga 15 korriku, është shumë e rëndësishme të mos na pengojnë punimet, sidomos për bizneset. KEDS-i ka punuar edhe më herët, por ka dështuar në të kaluarën, ndaj kemi frikë se ky projekt mund të përsëritet njësoj.

Fatmir Jashari: Kanali primar mund të përfundojë më pak se 1 muaj e gjysmë, por komplet punimet do të zgjasin rreth 2 muaj e gjysmë. Nëse fillojmë punimet, por dikush nuk lejon hapjen e kanalit para objektit të tij, do të ketë vonesa. Nëse kemi mbështetjen tuaj, procesi do të shkojë më shpejt. Kemi kaluar 12 vjet me infrastrukturë të rënduar, dhe e dimë që kjo është një rrugë e ngushtë, por me mbështetjen tuaj dhe të Policisë, projekti mund të kryhet shumë më shpejt.

Ne do të përpiqemi ta përfundojmë përpara afatit, që kur të kthehen mërgimtarët, të mos ketë më probleme. Në total, projekti zgjat 2 muaj e gjysmë, por për secilin biznes para lokalit të tij, puna mund të zgjasë vetëm 2 orë. Do të gjejmë mënyrën më të lehtë, që të jetë sa më i favorshëm për konsumatorët.

Abedin Milaku: Përshëndetje, Kryetar! Përshëndetje të gjithëve! Kam 2-3 çështje që dua të diskutoj. E para, e dimë që punimet do të sjellin sfida dhe do të jetë e pamundur të shmangim problemet. E dyta, sa i përket ormanit, i cili është i planifikuar të ndërtohet me beton, kjo po shkakton polemika për mënyrën e implementimit. Ne, si operatorë, marrim përgjegjësi vazhdimisht, por po hasim vështirësi në qasjen deri te klientët. Në Shtime operojnë 5 kompani,

dhe për të qenë korrekt me njëri-tjetrin, duhet të shmangim dëmtimet dhe të kemi një bashkëpunim të koordinuar.

Fatmir Jashari: I nderuar, ne ju kemi dërguar një ofertë për të realizuar betonimin ngjitur me betonin tonë. Kemi propozuar që operatorët të kontribuojnë, sepse për Shtimen kjo kosto është rreth 7,000 - 8,000 euro, ndërsa për secilin prej jush do të ishte rreth 1,500 euro. Besoj që edhe ju si operatorë e keni interesin ta realizoni këtë investim.

Abedin Milaku: Ju faleminderit për sqarimin!

Muhamet Grajqevci: Përshëndetje të gjithëve! Jam përfaqësues i Elsa Tech dhe kam një pyetje për përfaqësuesin e KEDS-it. A do të ketë reduktime të energjisë elektrike në janar dhe dhjetor, siç ka ndodhur më parë? Ne kemi pasur probleme të mëdha prej 15 dhjetorit deri më 15 janar.

Fatmir Jashari: Sa i përket nderprerjeve të energjisë, kjo nuk është në kompetencën time për ta komentuar. Megjithatë, në këtë projekt ne do të realizojmë kanalin nga Fitorja deri te Trekëndëshi, dhe deri në këtë pikë mund të ketë një ndikim në furnizimin me energji. Ndërprerjet e mëparshme kanë pasur arsye të tjera, dhe e dimë që keni qenë të lidhur në një trafo. Kur të shtohet një trafostacion i ri, furnizimi do të forcohet.

Qemajl Aliu: Sa i përket operatorëve, për hir të së vërtetës, në komunën tonë, ju funksiononi pothuajse ilegalisht, pasi shumë prej kabllave nuk janë të kyçura në kanale të rregulluara. Kjo është në interesin tuaj, sepse përfitimet shkojnë drejt kompanive tuaja, jo drejt komunës. Nuk është e drejtë që kërkesat të adresohen në këtë mënyrë. Ilegaliteti ka arritur në një pikë ekstreme, saqë kur kemi ndërtuar rrjetin e ri të ndriçimit, disa operatorë privatë kanë vendosur kabllot në shtyllat e ndriçimit. Ju lutem, kjo nuk është etike, të shtrini rrjetin për interesin e kompanisë suaj, duke dëmtuar infrastrukturën e komunës, e cila është ndërtuar me taksa të qytetarëve. Ne jemi këtu për të marrë vendimin nëse e marrim përsipër këtë projekt. Për mua, shqetësimi nuk janë operatorët, por bizneset dhe qytetarët, të cilët janë prekur nga kjo situatë.

Në fund të fundit, operatorët po veprojnë ilegalisht duke shfrytëzuar shtyllat e KEDS-it dhe prona publike, ndërsa faturat paguhen te operatorët. Kjo nuk është në rregull! Besoj se keni përfituar mjaftueshëm, dhe tani duhet të operoni ligjërisht.

Abedin Milaku: Ne si Telkos kemi leje nga qeveria e kaluar për të shfrytëzuar shtyllat e ndriçimit publik, me miratimin e komunës.

Qemajl Aliu: Rrjeti i ndriçimit publik nuk është i projektuar për të përballuar trafostacione shtesë. Këto trafo po dëmtojnë edhe shtyllat e betonit, e lëre më shtyllat e KEDS-it. Ne jemi duke investuar 500,000 euro për 48 km rrjet të ri, dhe kabllot e operatorëve nuk mund të shkatërrojnë këtë investim. Kushdo që ju ka lejuar këtë praktikë, e ka gabim. Ne do të largojmë këto kabllot, sepse nuk ka kuptim, infrastruktura publike nuk e duron këtë presion. Si Kryetar, unë përfaqësoj taksat e qytetarëve, dhe nuk duhet të cenohet e drejta as e qytetarëve, as e bizneseve.

Nëse nuk ka diçka tjetër për të shtuar, ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrjen. Ne do të analizojmë çdo mendim, koment dhe vlerësim nga ju dhe do t'ju informojmë me një postim publik. Shpresojmë që do të ia dalim, dhe do të mundohemi të analizojmë shqetësimet tuaja. Çdo investim që realizojmë, përpiqemi ta bëjmë në harmoni dhe dakordim me qytetarët. Do të mbetemi në komunikim të vazhdueshëm për ta implementuar këtë projekt, sepse është shumë i domosdoshëm për komunën tonë. Të gjithë e shohim që kabllot në hapësirën publike nuk janë një pamje e mirë. Por do të gjejmë një mënyrë elegante, që as të mos dëmtojmë projektin, por edhe të sigurojmë një zgjidhje të qëndrueshme.

Do të krijojmë një fleksibilitet, ku të gjithë të paguajnë një kosto më të vogël, por të realizojmë një projekt me vlerë të madhe për qytetin.

Ju falënderoj të gjithëve!

Mbledhja ka përfunduar në ora 15:15











Procesmbajtës:





Vlora Hyseni



**LISTA E PJESËMARRËSVE NE TAKIM PUBLIK ME QYTETARË PËR PROJEKTIN E
KEDS-it (Shtirirja e rrjetit nëntokësorë të kabllave)**

- Shtime, 5 maj 2025

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	HAKI LLUGA XHIA	BIZNES	
2	FANOL HASENI	BIZNES	
3	KAZEM ADEMI	BIZNES	
4	ESAD HYSI	BANOR	
5	LULZIM MUSTAFI	BIZNES	
6	Edon Cerini	D4-Net - Katese	
7	Sadat Metushi	D4-Net - Kujtesa	
8	Lindrit Krasnigi	Kujtesa Net	
9	REFU LATIFI	QYTETAR	
10	Ahmet Limani	Qytetar	
11	Besmir Pina	BIZNES	
12	ADAE ISUFI	BIZNES	
13	Kherrat Qazari	Telekom	
14	BEHAR SACIRI	IPKO	
15	ARBEN SYLEJMANI	IPKO	
16	Perparim Shabani	Telkos	
17	Muhamet Maloku	Telkos	

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
18	Muhamet Grogjovci	ELSA-TECH	
19	Grejtalb Eminio	Komune	
20	BLEND FEJZA	KEDS	
21	HADIT UZIRAJ	ARW GROUPSHK	
22	FATMIR JASHARI	ICEDS	
23	Albion Shabani	K. Shtime	
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			

